



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 3 i Regj. Themeltar  
Nr. 3 i Vendimit**

**VENDIM**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

<b>Ilir PANDA</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Sandër SIMONI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Sokol BINAJ</b>	<b>Anëtar</b>

sot, në datë 08.06.2021, mori në shqyrtim, në dhomë këshillimi, çështjen penale me nr.3-2021 Regj.Them, që i përket:

**KËRKUES:**

Egon Velaj,  
Denis Metaj,  
Artan Metaj,

**OBJEKTI:**

Pezullimi i ekzekutimit të dënimit të vendimit nr.183, datë 15.10.2020 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

**BAZA LIGJORE:**

Neni 432 e vijues i Kodit të Procedurës Penale.

**KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit Sokol Binaj dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I. Rrethanat e çështjes**

1- Kërkuesit Egon Velaj, Denis Metaj dhe Artan Beqiri, nëpërmjet avokatit mbrojtës të autorizuar me prokurë të posaçme, kanë paraqitur në Gjykatë të Lartë së bashku me rekursin, kërkesën me objekt: “Pezullimi i ekzekutimit të dënimit të vendimit nr.183, datë 15.10.2020 të Gjykatës së Apelit Vlorë”.

2- Rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka paraqitur për gjykim procedimin penal me nr.517 të vitit 2018 për të pandehurit Egon Velaj, Denis Metaj,

Artan Beqiri, Erald Ymeraj, Daniela Kondaj dhe Xhilda Korkaj për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 e 25 i Kodit Penal.

3- Rezulton se me vendimin nr. 425, datë 23.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i lënë në fuqi me vendimin 183, datë 15.10.2020 të Gjykatës së Apelit Vlorë, është vendosur:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Egon Velaj, për kryerjen e veprës penale “Shpërdorim detyre” në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 248 e 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim.

- Në aplikim të nenit 59 të K.Penal pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim për të pandehurin Egon Velaj duke e vënë në provë për një periudhë kohe një prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh, me kusht që të mbaj kontakte me Shërbimin e Provës Vlorë dhe të mos kryejë vepër tjetër penale. I pandehuri detyrohet të njoftoj Shërbimin e Provës Vlorë lidhur me ndryshimin e vendbanimit.

- Në aplikim të nenit 35 të K.Penal, të pandehurit Egon Velaj i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 1 (një) vit.

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Artan Beqiri, për kryerjen e veprës penale “Shpërdorim detyre” në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 248 e 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim.

- Në aplikim të nenit 59 të K.Penal pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim për të pandehurin Artan Beqiri duke e vënë në provë për një periudhë kohe një prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh, me kusht që të mbaj kontakte me Shërbimin e Provës Vlorë dhe të mos kryejë vepër tjetër penale. I pandehuri detyrohet të njoftoj Shërbimin e Provës Vlorë lidhur me ndryshimin e vendbanimit.

- Në aplikim të nenit 35 të K.Penal, të pandehurit Artan Beqiri i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 1 (një) vit.

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Denis Metaj, për kryerjen e veprës penale “Shpërdorim detyre” në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 248 e 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim.

- Në aplikim të nenit 59 të K.Penal pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim për të pandehurin Denis Metaj duke e vënë në provë për një periudhë kohe një prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh, me kusht që të mbaj kontakte me Shërbimin e Provës Vlorë dhe të mos kryejë vepër tjetër penale. I pandehuri detyrohet të njoftoj Shërbimin e Provës Vlorë lidhur me ndryshimin e vendbanimit

- Në aplikim të nenit 35 të K.Penal, të pandehurit Denis Metaj i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej 1 (një) vit.

## **II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë**

4- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) evidenton se kërkuesi ka paraqitur në Gjykatë të Lartë rekurs ndaj vendimit me nr.183 datë 15.10.2020 të Gjykatës së Apelit Vlorë ku pjesë e këtij rekursi ka edhe kërkesën me objekt: “Pezullimi i ekzekutimit të dënimit të vendimit nr.183, datë 15.10.2020 të Gjykatës së Apelit Vlorë”. Në këtë rekurs evidentohen kërkime në lidhje me kundërshtimin e vendimit me nr.183 datë 15.10.2020 të Gjykatës së Apelit Vlorë, ndërsa në lidhje me kërkimin për pezullimin e ekzekutimit nuk konstatohet asnjë parashtrim të rrethanave sipas nenit 417 dhe 476/1 i KPP.

5- Neni 432 i Kodit të Procedurës Penale, në pikën 1 të tij, parashikon se rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji material ose procedural i cili është me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e

provave; ose kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

6- Kolegji vlerëson se kërkesa e kërkuarve nuk ka elementët e nevojshëm për tu trajtuar pasi nuk ka asnjë parashtrim të rrethaveve të parashikuar nga neni 467/1 i KPP si dhe nuk ka asnjë akt provues në lidhje me ndonjë pretendim të mundshëm.

7- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson se, kërkesa e paraqitur në Gjykatën e Lartë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, nuk përmban elementët formal për trajtim dhe për rrjedhojë nuk mund të pranohet.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenet 433 të Kodit të Procedurës Penale,

### **V E N D O S I:**

Mospranimin e kërkesës të paraqitur nga kërkuesit Egon Velaj, Denis Metaj dhe Artan Beqiri, kundër vendimit Nr. 183, datë 15.10.2020, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

**Tiranë, më 08.06.2021**

**A N Ë T A R**

**A N Ë T A R**

**K R Y E S U E S**

**Sokol BINAJ**

**Sandër SIMONI**

**Illir PANDA**